

VENDIM
Nr.67, datë 10.2.2010

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT (IZHA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA), si institucion publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e Institutit të Kurrikulave dhe Trajnimit (IKT).

2. Misioni i IZHA-së është që t’u ofrojë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore të të gjitha niveleve ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, të mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore studimore dhe praktikës së arsimit.

3. Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka për detyrë:

a) t’u ofrojë ekspertizë strukturave politikëpërbërëse dhe vendimmarrëse për politikatat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit;

b) të zhvillojë punë kërkimore-studimore dhe të ofrojë ekspertizë e këshillim për institucionet arsimore të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;

c) të mbështesë MASH-in në hartimin e studimeve/analizave periodike, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;

ç) të ofrojë këshillim për nxënësit dhe qytetarët në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;

d) të zhvillojë metodologji për sigurimin e cilësisë e vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe programet e tyre mësimore;

dh) të zhvillojë programe dhe standarde për kualifikimin e mësuesve, profesoratis dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore;

e) të zhvillojë metodologji dhe standarde për tekstet mësimore;

ë) të zhvillojë veprimtarë informative për institucionet, nxënësit, studentët, punëdhënësit dhe punëmarrësit;

f) të kryejë edhe detyra të tjera, të ngarkuara nga MASH-i dhe qeveria, brenda misionit të tij.

5. Statuti dhe rregullorja e funksionimit të IZHA-së miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Drejtuesi i IZHA-së emërohet, lirohet a shkarkohet nga detyra me urdher të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të IZHA-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

8. Numri i punonjësve të IZHA-së të jetë i përfshirë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

10. IZHA-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

11. Buxheti i planifikuar për Institutin e Kurrikulave dhe Trajnimit, si dhe të gjitha asetet e tij i kalojnë IZHA-së.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
13. Vendimi nr.418, datë 11.7.2007 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Kurrikulave dhe të Trajnimit”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha